

Sqarim për median

Tiranë, më 13 Tetor 2022: Në artikullin me titull “**Aggression on Ukraine as Social Bomb of the Entire Globe**”, botuar në gazetën Albanian Daily News më datë 13/10/2022, ku thuhet se “78 % e popullsisë janë në rrezik për të qenë të varfër dhe 74,7 % në moshë pune janë në rrezik për të qenë të varfër si rezultat i papunësisë” sqarojmë se ky indikator nuk qëndron, përkundrazi 78 % përbën popullsinë jo në rrezik për të qenë të varfër (non-poor) për vitin 2020.

Sipas publikimit të fundit të bërë nga EUROSTAT treguesi “Popullsia në moshë pune në rrezik për të qenë të varfër si rezultat i papunësisë”, 74,7 % (për të cilin është paraqitur lajmi në formën jo të duhur) ka të bëjë me përqindjen e individëve në rrezik për të qenë të varfër të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim.

Shifra e publikuar në *Abanian Daily News*, 74,7 % dhe grup-mosha e paraqitur në lajm, nuk është reale meqenëse kjo shifër përfaqëson përqindjen e individëve në forcë pune në rrezik për të qenë të varfër të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim dhe jo popullsinë në tërësi në moshë pune në rrezik për të qenë të varfër si rezultat i papunësisë. Shifra 74,7 % gjithashtu nuk i përket grup-moshës në forcë pune, siç është paraqitur në lajm, por grup-moshës 0-18 vjeç. I njëjti lajm lidhur me këtë tregues është publikuar muaj më parë në Revistën Monitor.

Sipas të dhënave të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC), popullsia në moshë pune 18-64 vjeç në rrezik për të qenë të varfër në vitin 2020 është 21,6 %. Gjithashtu, individët e grup-moshës 18-59 vjeç të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim, përbëjnë 11,6 % në vitin 2020.

13/10/2022

Intensiteti shumë i ulët në punësim i referohet situatës së personave në familje ku asnjë nuk punon, ose punon shumë pak, që do të thotë se anëtarët e familjes në moshë pune punojnë më pak se 20 % e numrit gjithsej të muajve që ata mund të punonin gjatë periudhës së referencës.

Treguesi i prodhuar nga EUROSTAT paraqet përqindjen e rrezikut të varfërisë mbi grup-moshën e popullatës me intensitet shumë të ulët në punësim (në rastin e Shqipërisë për grup-moshën 18-59 vjeç llogaritet treguesi i rrezikut për të qenë i varfër mbi 11,6 % të popullatës së kësaj grup-moshe që jetojnë me intensitet shumë të ulët në punësim).

Në linkun e mëposhtëm gjendet publikimi i realizuar nga EUROSTAT:

<https://ec.europa.eu/eurostat/en/web/products-eurostat-neës/-/DDN-20220804-1>

Sipas EUROSTAT, përqindja e popullsisë në moshë pune (18-64 vjeç) në rrezik për të qenë të varfër që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim është 66,7 % për vitin 2020.


Në tabelën e mëposhtme gjendet treguesi sipas grup-moshave:

Tabela 1: Rreziku për të qenë i varfër tek individët që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim (%)

Grup-mosha	2020
0-18 vjeç	74,7
18-64 vjeç	66,7
0-64 vjeç	68,8

Shqipëria, lidhur me këtë tregues për grup-moshën 18-64 vjeç për vitin 2020, është 5 pikë përqindje më shumë sesa mesatarja e Bashkimit European ku ky tregues është në nivelet 61,7 %.

Figura 1: Rreziku për të qenë i varfër tek individët që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim në BE



Burimi: EUROSTAT 2020

Ju lutemi këtë sqarim ta publikoni në median tuaj si qëndrim të INSTAT ndaj këtij artikulli.